

VENDIM
Nr. 19, datë 4.2.2022

MBI SHTYRJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT, PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “HERA” SHPK, PËR TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS NR. 49, SERIA NPM07P, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT NR. 61, DATË 2.11.2007, “PËR NDËRTIM, INSTALIM, SHFRYTËZIMIN DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALE ME ERË (PROJEKTI KAPPET)”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 4.2.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi transferimin e plotë të licencës së shoqërisë ‘Hera’ sh.p.k. nr. 49, seria NPM07P, dhënë me vendimin e Bordit nr. 61, datë 2.11.2007, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, i ndryshuar,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 240, datë 2.12.2021, vendosi:

“1. Të fillojë procedurën për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k. me nr. 49, seria NPM07P, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, me kapacitet të instaluar 150 mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Vendimi përfundimtar për transferimin e licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k. do të merret pasi Bordi i ERE-s të jetë shprehur në lidhje me shtyrjen ose jo të afateve të plotësimit të kushteve të vendimit nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar.”.

- Në lidhje me pikën 2 të dispozitivit të vendimit nr. 240/2021, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 25, datë 13.12.2021, vendosi ndër të tjera:

“1. Të zgjasë me 9 (nëntë) muaj afatin e plotësimit të kushteve të vendosura në pikën 3.1, 3.2 dhe pikën 4, gjerat “a” dhe “b” (leja e mjedisit, dokumentacioni pronësor, miratimi nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale dhe dokumentacioni përkatës).”.

- Në vijim të vendimit nr. 240/2021, për fillimin e procedurës së transferimit të licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k., me nr. 49, seria NPM07P, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, të ndryshuar, u bë njoftimi në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure, me shkresën nr. 6/27 prot., datë 2.12.2021, dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve nga palët e treta (data 17.12.2021), nuk rezultoi asnjë koment.

- Sa i përket dokumentacionit të këtij aplikimi, gjatë shqyrtimit në Bord të kësaj praktike, lindi nevoja e dhënies së sqarimeve dhe depozitimit të dokumentacionit përkatës, në lidhje me sa më poshtë:

- Shoqëria “SOT–AL” sh.p.k. duhet të dokumentojë në ERE ekstraktin historik të saj të depozituar në QKB, me objektin e veprimtarisë të shtuar sipas titullit të licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k.: “Ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”;

- Shoqëria “SOT–AL” sh.p.k. duhet të dokumentojë në ERE numrin e punonjësve të dedikuar për veprimtarinë e licencuar që pretendohet t’i transferohet nga shoqëria “Hera” sh.p.k., si dhe profilin e tyre, në vijim të zotimit që kjo e fundit ka bërë në aktmarrëveshjen paraprake, të datës 30

nëntor 2021, me palë kërkuese shoqërinë “Hera” sh.p.k. dhe palë marrëse shoqërinë “SOT–AL” sh.p.k., në të cilën shkruhet se do të mbështesë me burime njerëzore plotësimin e kushteve të vendosura në licencë dhe afatet nga ERE për zbatimin e projektit;

- Shoqëria “SOT–AL” sh.p.k. duhet të dokumentojë në ERE kapacitetin e saj financiar, në përputhje me vlerën e investimit të këtij projekti, pasi të ardhurat e dokumentuara në ERE vlerësohen si të pamjaftueshme për të mundësuar zhvillimin e projektit KAPPET.

- Shoqëria “SOT–AL” sh.p.k. duhet të bëjë me dije nëse ka aplikuar në lidhje me rinovimin e kontratave të qirasë të zonës ku do të zhvillohet projekti KAPPET dhe nëse po, t’i depozitojë ato në ERE, në vijim të parashikimeve të nenit 4, pika 3, të aktmarrëveshjes paraprake, të datës 30 nëntor 2021, me palë kërkuese shoqërinë “Hera” sh.p.k. dhe palë marrëse shoqërinë “SOT–AL” sh.p.k., ku ndër të tjera citohet se: “çdo palë është e detyruar të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të lejuar e kaluar të gjithë dokumentacionin që pala kaluese i transferon palës marrëse dhe lejuar palën marrëse të përmbushë detyrimet e parashikuara në lidhje me përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga licenca e ERE-s....”.

- Në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me qëllim sqarimin/dokumentimin e konstatimeve të mësipërme, vlerësohet e arsyeshme shtyrja me 30 ditë pune e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k. për transferimin e licencës së marrë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 61/2007, të ndryshuar, të shoqëria “SOT–AL” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen përfundimtare të Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Hera” sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë “Hera” sh.p.k. nr. 49, seria NPM07P, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 61, datë 2.11.2007, “Për ndërtim, instalim, shfrytëzimin dhe prodhimin e energjisë elektrike nga centrale me erë (projekti KAPPET)”, i ndryshuar, për plotësimin e dokumentacionit të munguar përpara marrjes së vendimit për transferimin e licencës të shoqëria “SOT–AL” sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti